



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizrenia "UKSHIN HOTI"	
Pranuar më dt.	16.10.2025
Zyra e pranimit	Nr. i protokolit
308	01-641

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren - Kosovë; Tel: +383 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Senati i Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, në kuadër të kompetencave të përcaktuara sipas Statutit, në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 04/L-037 për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës dhe Rregulloren nr. 01-377/A për angazhimin e bashkëpunorëve të jashtëm në Universitetin "Ukshin Hoti", në mbledhjen e mbajtur më datë: 13.10.2025 vendosi të shpallë:

KONKURS - RISHPALLJE

Për angazhimin e bashkëpunorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime në bazë të nevojave të njësive akademike të Universitetit "Ukshin Hoti" për vitin akademik 2025/26.

Angazhimi me honorar i bashkëpunorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime do të bëhet bazuar në propozimet e njësive akademike, në pajtim me Ligjin nr. 04/L-037 për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës, dispozitat e Statutit të Universitetit dhe legjislacionit tjetër në fuqi mbi marrëdhënien e punës sipas procedurës së paraparë në dispozitat e Rregulloren nr. 01-377 për angazhimin e bashkëpunorëve të jashtëm në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren.

a) Kushtet e përgjithshme për angazhim:

- I. Personeli i jashtëm akademik mund të angazhohet në Universitet për një periudhë të caktuar, me qëllim të realizimit të veprimtarisë arsimore e shkencore mbi bazën e një konkursi publik për bashkëpunorë të jashtëm (me honorar). Angazhimi nuk nënkupton sipas këtij konkursi themelim të marrëdhënies së punës dhe marrje të thirrjes akademike e as pagesë me automatizëm gjatë periudhës për të cilën angazhohet.
- II. Në Universitetin "Ukshin Hoti" nuk mund të angazhohen kandidatët të cilët përveq kontratës primare me normë të plotë kanë edhe një angazhim sekondar në institucione publike.
- III. Angazhimi me honorar i bashkëpunorëve të jashtëm bëhet në mënyrë transparente në përputhje me Rregulloren nr. 01-377/A për angazhimin e bashkëpunorëve të jashtëm në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren.

b) Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Kërkesa për aplikim;
- Biografinë (CV);
- Certifikata/ekstrakti i lindjes;
- Certifikata penale (dëshmi nga gjykata mbi të kaluarën penale);
- Kopja e diplomës përkatëse e noterizuar nga organi kompetent, (kandidatët që kanë diplomuar jashtë Republikës së Kosovës, duhet të sjellin edhe vendimin e nostrifikimit të diplomës përkatëse si: baçelor, master, magjistraturë, dhe doktoraturë);

- Kandidatët të cilët aplikojnë për pozitën e asistentit, lektorit apo korepetitorit, duhet të sjellin edhe certifikatën e notave të studimeve baçelor dhe master;
 - Dëshmi për publikime shkencore e profesionale, si dhe informata të tjera specifike shtesë;
 - Dëshmi për angazhime në Universitet (nëse kanë qenë të angazhuar më parë) ose në ndonjë institucion tjetër (të akredituar) të arsimit të lartë;
 - Kandidatët që nuk kanë shtetësi të Republikës së Kosovës, duhet të sjellin dëshminë e lejeqëndrimit. Nëse nuk kanë qëndrim rezident në Republikën e Kosovës, të sjellin një deklaratë nën betim që nuk janë banorë rezident në Republikën e Kosovës.
 - Dëshmia për njohjen e gjuhëve të huaja, (njohja e gjuhës angleze ose e ndonjë gjuhë tjetër të huaj është përparësi).
 - Pëlqimi i eprorit në rastet kur kandidati është i punësuar në një institucion publik apo privat.
- *Dokumentacioni duhet të jetë origjinal ose i noterizuar (jo kopje i noterizuar) dhe duhet të jetë i plotë për të gjitha pozitat në të cilat aplikon kandidati, që nënkupton se kandidatët me dosje të pakompletuara në cilën do pozitë, do të skualifikohen automatikisht nga për zgjedhja.*
 - *Kandidatët duhet të aplikojnë me dosje të kompletuar për secilën pikë, veç e veç, dhe me kërkesë të veçantë për secilën prej tyre. Aplikimet që përfshijnë më shumë se një pikë në një dosje të vetme nuk do të merren në konsideratë.*
 - *Funksionari publik, zyrtari publik, zyrtarët e tjerë, si dhe stafi akademik universitar, të cilët shprehin interesin për angazhim sipas këtij konkursi përveç dokumentacionit të përmendur më lart, duhet të zbatojnë në përpikmëri dispozitat e paragrafit 4 të nenit 4 të Rregullores së Qeverisë nr. 09/2023 për Shtesën Funksionale (cit: “4.1.njofton dhe merr miratim nga udhëheqësi më i lartë administrativ i institucionit ku është i punësuar me kontratë primare (me kohë të plotë); 4.2.dorëzon në institucionin ku do të kryejë angazhimin shtesë vërtetimin e pagës bazë të pozitës ku është i punësuar me kontratë primare (me kohë të plotë)”). Për stafin akademik të rregullt në njërin nga Universitetet publike miratimin e jep titullari i institucionit, në zbatim të akteve të brendshme nën ligjore.*

I. FAKULTETI EKONOMIK

1. Një Profesor për lëndët:

Semestri Dimëror:

- Anglishtja Afariste I (AB, 4 orë L)
- Anglishtja Afariste III (AB, 2 orë L)

2. Një Asistent për lëndët:

Semestri Dimëror:

- Bazat e Marketingut (AB, 4 orë U)
- Bazat e Menaxhimit Ndërkombëtar (MN, 4 orë U)

II. FAKULTETI I FILOLOGJISË

Dega e Gjuhës dhe e Letërsisë Gjermane

I. Një asistent për lëndët e gjuhësisë gjermane:

Semestri dimëror:

- Gjuhë Gjermane V - Praktikë gjuhe (B2/1), 21-5-B-24-S5-O1 (5 orë U);
- Gjermanishtja e ekonomisë, 24-5-B-24-S3-O5 (1 orë U);
- Analizat dhe përgatitja e mësimdhënies së gjermanishtes si gjuhë e huaj, 21-5-B-24-S5-Z6 (1 orë U).

Semestri veror:

- Gjuhë Gjermane VI - Praktikë gjuhe (B2/2), 21-5-B-24-S6-O1 (5 orë U);
- Praktikë profesionale në shkollë, 21-5-B-24-S6-O3 (2 orë U).

Dokumentacioni dorëzohet në kopje fizike, në fakultetet përkatëse te Sekretari i njësisë akademike, çdo ditë pune nga ora 09:00 deri në orën 15:00, në objektet e Universitetit "Ukshin Hoti" adresa: "Rruga e Shkronjave", nr. 1, 20000 Prizren, si dhe e njëjta në kopje elektronike e dërgohet edhe në e-mail-in zyrtar: apliko.upz@uni-prizren.com (*Aplikimi i kandidatit nuk merret në konsideratë nëse nuk dorëzohet në të dy format: fizike dhe elektronike*). Të drejtë aplikimi, pa asnjë diskriminim, kanë të gjithë kandidatët e interesuar, të cilët i plotësojnë kriteret ligjore dhe ato të konkursit.

Konkursi mbetet i hapur 5 ditë nga dita e publikimit në ueb-faqen e Universitetit respektivisht deri më datë: 21.10.2025. Publikimi i listave me kandidatët e përzgjedhur bëhet në faqen zyrtare të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren.

Procedura e përzgjedhjes së personelit të angazhuar dhe afati i ankesave është e paraparë në Rregulloren në fuqi; të cilën mund ta gjeni në: www.uni-prizren.com

Vërejtje:

Kuptimi i inicialeve: **Obligative (O)**, dhe **Zgjedhore (Z)**, **Ligjërata (L)** dhe **Ushtrime (U)**.

Të gjitha pikat e konkursit që parashohin lëndë zgjedhore, për të cilat nuk plotësohet numri minimal i studentëve për formimin e grupeve sipas rregullores, do të anulohen, prandaj Universiteti "Ukshin Hoti" paraprakisht u bënë të ditur kandidatëve se përzgjedhja e tyre lidhet me këtë kusht. Njësitë Akadematike dalin me njoftime zyrtare rreth lëndëve zgjedhore.

NJMBNJ